



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 105, 117.4, dhe 118.5 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe Vendimeve të PZAP-së, të pranura në KQZ, me Aktin përcjellës më datën 07.11.2021, Nr.2991/2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 08.11.2021, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Rinumërim të Fletëvotimeve

- I. Miratohet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve në kutitë e votimit, sipas vendimeve të PZAP-së të dorëzuara në KQZ me Aktin përcjellës me nr.2991/2021, të datës 07.11.2021.
- II. Tabela me vendvotimet të cilat do të rinumërohen i është bashkëngjitur këtij vendimi.
- III. Rezultati i dalë pas rinumërimit të kutive të votimit, si në pikën I, të këtij vendimi të përfshihet në rezultatet përfundimtare.
- IV. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Arsyetim

Duke u bazuar në vendimet e PZAP-së, të dorëzuar në KQZ me Aktin përcjellës me Nr.2991/2021, të datës 07.11.2021, lidhur me ankesat e parashtruara nga subjektet politike dhe kandidatët e tyre, të paraqitura kundër vendimit të KQZ-së, nr.2945/2021, i datës 03.11.2021, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për zgjedhjet lokale 2021, përmes të cilave urdhërohet KQZ-ja për rinumërim të fletëvotimeve, si dhe duke u bazuar në propozimet e dala nga mbledhja e KQZ-së për rinumërim të të gjitha fletëvotimet në kutitë e votimit, sipas vendimeve të PZAP-së. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 08.11.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi

